

UDHËTIMI NË SHQIPËRI

Nismë informuese për promovimin e barazisë dhe mbrojtjen nga diskriminimi

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI



RRETH NISMËS

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi do të zhvillojë gjatë periudhës shtator-dhjetor 2026 nismën “Udhëtimi në Shqipëri”, me qëllim afrimin e institucionit me komunitetet në zona ku aksesit në informacion dhe në mekanizmat institucionalë të mbrojtjes është më i kufizuar.

Nisma do të realizohet përmes dialogut me qytetarët, institucionet vendore, shkollat, organizatat e shoqërisë civile dhe përfaqësuesit e grupeve në situata vulnerabiliteti. Çdo aktivitet do të trajtojë një tematikë të lidhur drejtpërdrejt me mandatin e KMD-së dhe me problematikat e zonës ku zhvillohet.

OBJEKTIVAT KRYESORE

- Rritja e njohurive të qytetarëve mbi të drejtën për barazi dhe mbrojtjen nga diskriminimi;
- Informimi mbi rolin e KMD-së dhe mënyrën e paraqitjes së ankesës;
- Identifikimi i pengesave dhe problematikave konkrete në nivel vendor;
- Forcimi i dialogut me institucionet dhe komunitetet lokale;
- Nxitja e bashkëpunimit me partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

FORMATI I AKTIVITETEVE

DIALOG

Bashkëbisedim me qytetarë, institucione vendore dhe aktorë komunitarë.

INFORMIM

Prezantim i rolit të KMD-së, fushave të mbrojtjes dhe procedurës së ankimit.

EVIDENTIM

Mbledhje e çështjeve dhe barrierave që mund të kërkojnë ndjekje institucionale.

Pjesëmarrja e partnerëve ndërkombëtarë mund të marrë formën e kontributit tematik, ndarjes së praktikave, pjesëmarrjes në dialog ose mbështetjes teknike, sipas mandatit dhe fushës së ekspertizës së secilës organizatë.

KALENDARI I AKTIVITETEVE - SHTATOR - DHJETOR

23 SHTATOR 2026 MALËSI E MADHE	Barazia në aksesin në shërbimet publike Aktiviteti synon të nxisë dialogun ndërmjet qytetarëve dhe institucioneve vendore mbi aksesin e barabartë në shërbimet publike, pengesat që hasin grupet në situata vulnerabiliteti dhe mekanizmat për mbrojtjen nga diskriminimi. Çështje orientuese për diskutim: Diskriminimi në ofrimin e të mirave dhe shërbimeve • Aksesin në shërbimet administrative, sociale dhe shëndetësore • Diskriminimi për shkak të vendbanimit, moshës ose gjendjes ekonomike • Aksesueshmëria dhe përshtatja e arsyeshme për personat me aftësi të kufizuara • Procedura e ankimit pranë KMD-së.
24 SHTATOR 2026 FUSHË-ARRËZ	Mbrojtja nga diskriminimi në komunitetet rurale Aktiviteti fokusohet te sfidat që hasin komunitetet rurale dhe malore në ushtrimin e të drejtave dhe në aksesin në arsim, punësim e shërbime publike. Çështje orientuese për diskutim: Trajtimi i pabarabartë i lidhur me vendbanimin • Barazia në aksesin në arsim, punësim dhe shërbime • Gjendja ekonomike dhe përjashtimi social • Diskriminimi ndaj grave dhe vajzave në zonat rurale • Mekanizmat e mbrojtjes dhe referimit të rasteve.
29 SHTATOR 2026 KUKËS	Përfshirja dhe aksesueshmëria për personat me aftësi të kufizuara Aktiviteti synon të promovojë aksesueshmërinë, përshtatjen e arsyeshme dhe respektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në arsim, punësim dhe shërbime publike. Çështje orientuese për diskutim: Diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar • Aksesueshmëria fizike, informative dhe digjitale • Përshtatja e arsyeshme • Barazia në arsim dhe punësim • Mbrojtja ligjore dhe praktika e KMD-së.
5 TETOR 2026 BULQIZË	Barazia në punësim dhe mbrojtja sociale Aktiviteti trajton diskriminimin në punësim dhe aksesin në mbrojtje sociale, me vëmendje të veçantë ndaj personave dhe familjeve në vështirësi ekonomike. Çështje orientuese për diskutim: Diskriminimi në rekrutim dhe marrëdhëniet e punës • Gjendja ekonomike si shkak diskriminimi • Aksesin në ndihmë ekonomike dhe shërbime sociale • Trajtimi i barabartë në shërbimet shëndetësore • Mbrojtja nga viktimizimi pas ankimit.

**5 TETOR 2026
KLOS**

Shërbime publike pa diskriminim

Aktiviteti synon të forcojë dialogun ndërmjet qytetarëve dhe administratës vendore mbi standardet e trajtimit të barabartë dhe ofrimit të shërbimeve publike pa diskriminim.

Çështje orientuese për diskutim: Diskriminimi i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë • Komunikimi institucional me qytetarët • Barrierat administrative dhe procedurale • Trajtimi i grupeve në situata vulnerabiliteti • Referimi i rasteve pranë KMD-së.

**20 TETOR 2026
LIBRAZHD**

Gratë dhe vajzat - Barazia dhe mundësitë e barabarta

Aktiviteti fokusohet në promovimin e barazisë gjinore dhe në pengesat që hasin gratë dhe vajzat, veçanërisht në zonat rurale, në aksesin në punësim, arsim, shërbime dhe pjesëmarrje publike.

Çështje orientuese për diskutim: Diskriminimi për shkak të gjinisë • Diskriminimi i shumëfishtë • Barazia në punësim dhe mundësitë ekonomike • Aksesin në arsim dhe shërbime • Ngacmimi seksual, viktimizimi dhe mekanizmat e mbrojtjes.

**28 TETOR 2026
MALLAKASTËR**

Barazia në marrëdhëniet e punës

Aktiviteti synon të promovojë respektimin e parimit të trajtimit të barabartë në rekrutim dhe në marrëdhëniet e punës, në sektorin publik dhe privat.

Çështje orientuese për diskutim: Diskriminimi gjatë rekrutimit • Trajtimi i barabartë në marrëdhëniet e punës • Ngacmimi dhe shqetësimi në vendin e punës • Zgjidhja e marrëdhënieve të punës për shkaqe diskriminuese • Kompetencat e KMD-së dhe procedura e ankimit.

**10 NËNTOR 2026
KOLONJË**

Diversiteti, toleranca dhe bashkëjetesa

Aktiviteti promovon respektimin e diversitetit kulturor, etnik, fetar dhe social dhe nxit dialogun ndërmjet komunitetit, shkollave dhe institucioneve vendore.

Çështje orientuese për diskutim: Diskriminimi ndaj pakicave dhe grupeve të veçanta • Stereotipet dhe paragjykimet • Gjuha e urrejtjes dhe kufijtë e lirisë së shprehjes • Bashkëjetesa dhe respekti për diversitetin • Roli i shkollave dhe institucioneve vendore në parandalim.

**11 NËNTOR 2026
PËRMET**

Arsimi gjithëpërfshirës dhe mbrojtja e fëmijëve nga diskriminimi

Aktiviteti synon të promovojë të drejtën e çdo fëmije për arsim cilësor dhe pa diskriminim, duke nxitur bashkëpunimin ndërmjet shkollës, familjes dhe institucioneve.

Çështje orientuese për diskutim: Diskriminimi në arsim • Bullizmi, përjashtimi dhe shqetësimi • Arsimi gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara • Mbrojtja e fëmijëve romë, egjiptianë dhe nga familje në nevojë • Bashkëpunimi shkollë-familje-institucione.

**2 DHJETOR 2026
RRËSHEN,
MIRDITË**

Të drejtat e njeriut dhe mekanizmat e mbrojtjes nga diskriminimi

Aktiviteti përmbyllës synon të prezantojë fushat dhe shkaqet e diskriminimit, mekanizmat e mbrojtjes dhe rolin e KMD-së, si dhe të reflektojë mbi problematikat e evidentuara gjatë nismës.

Çështje orientuese për diskutim: Diskriminimi në punësim, arsim dhe të mira e shërbime • Shkaqet dhe format e diskriminimit • Gjuha e urrejtjes dhe komunikimi publik • Roli i institucioneve vendore në parandalim • Kompetencat e KMD-së dhe procedura e ankimit.

FTESË PËR BASHKËPUNIM

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mirëpret pjesëmarrjen e organizatave ndërkombëtare në një ose më shumë aktivitete të nismës, në përputhje me mandatin, ekspertizën dhe interesin e secilit partner.

MËNYRAT E KONTRIBUTIT

KONTRIBUT TEMATIK

Pjesëmarrje me ekspertizë dhe mesazhe të lidhura me temën e aktivitetit.

DIALOG ME KOMUNITETIN

Pjesëmarrje në diskutimet me qytetarët, institucionet dhe aktorët lokalë.

PRAKTIKA DHE PËRVOJA

Ndarje e praktikave të mira, instrumenteve dhe përvojave ndërkombëtare.

BASHKËPUNIM I MËTEJSHËM

Identifikim i mundësive për iniciativë të përbashkëta në nivel vendor.